



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2753/Prot.  
2

Tiranë, më 24.12.2020

VENDIM

Nr. 49, datë 23.12.2020

**“Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Gjuhë për zhvillimin turistik të territorit" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT”**

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, germa b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, germa “dh”; neni 75; Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njëjësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, germa “A”; Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “F” si dhe në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me shkresën e fundit Nr. 731 Prot., datë 07.12.2020, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 23.12.2020;

**VENDOSI:**

1. Të hapë programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Gjuhë për zhvillimin turistik të territorit", në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT-së, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Gjuhë për zhvillimin turistik të territorit", të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t'i përcillet për miratim Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

